**KËRKESË**
**Nr. 4041/2, datë 23.9.2016**

**PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Ministria e Punëve të Brendshme shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Zgjerim dhe rikonstruksion i bulevardit "Fan Noli", në Bashkinë e Korçës.

Subjekti kërkues është Bashkia e Korçës.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat, të cilët preken nga ky shpronësim, që konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur, në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000, të Këshillit të Ministrave, "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik", të ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët do të likuidohen për efekt shpronësimi me paraqitjen e dokumenteve të rregullta të pronësisë, pas daljes së vendimit të Këshillit të Ministrave, që do të miratojë kërkesën për shpronësim. Vlera totale e shpronësimit është 702 083 (shtatëqind e dy mijë e tetëdhjetë e tre) lekë.

ZËVENDËSMINISTËR I MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME
**Elona Gjebrea**

Lista e pronave dhe e pronarëve që do të shpronësohen për realizimin e projektit
"Zgjerim dhe rikonstruksion i bulevardit "Fan Noli", në Bashkinë e Korçës

| Nr, Rendor | Emër Atësia Mbiemër | Zona Kadastrale | Nr. Pasurie | Lloji i Pas. | Truall. (m2) ZVRPP | Sip. e cila shpronësohet | Çmimi lekë/ m² | Vlera totale e shpronësimit | Vërtetim nga ZRPPP |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Riza Kollel Kalemi<br>Pranvera Veliu<br>Aferdita Veliu<br>Gazmend Veliu | 8564 | 1/39 | T+ND | $534.0\ m^2 - 179.8\ m^2$ | 82.24 | 8537 | 702 083 | Konfirmim nga ZRPPP |
| | **Totali** | | | | | | | **702 083** | |